



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 24.3.2023

Nr: 202

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**VLERËSIMIN E RAPORTIMEVE TË VEPRIMTARIVE ME KARAKTER PUBLIK TË DISA
INSTITUCIONEVE, PËR PERIUdhËN 3 MARS – 9 MARS 2023**

Sot, më datë 24.3.2023, unë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mora në shqyrtim çështjen administrative me

SUBJEKT: Kryeministria, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Kulturës, Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambli Popullor, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Prefekti i Qarkut Elbasan, Njësia Administrative nr. 9, Qendra Komunitare Multidisiplinare, Bashkia Belsh, Bashkia Elbasan, Bashkia Gjirokastrë, Bashkia Gramsh, Bashkia Kolonjë, Bashkia Korçë, Bashkia Lezhë, Bashkia Maliq, Bashkia Pogradec.

OBJEKTI: Vlerësimi i raportimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve për periudhën 3 mars deri më 9 mars 2023.

BAZA LIGJORE: Nenet 19 pika 1, shkronja “n” dhe 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.

Data: 24.3.2023 Nr. 202
Ora: 12:00



“Për vlerësimin e raportimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 3 mars – 9 mars 2023”

Në përfundim të këtij shqyrtimi

KONSTATOJ:

Gjatë periudhës 3 mars deri më 9 mars 2023, në ndërfaqen e raportimit të veprimtarive publike, janë raportuar gjithsej 272 aktivitete, nga 59 institucione. Nga verifikimi paraprak rezulton se nga këto, 40 aktivitete të zhvilluara nga 19 institucione janë raportuar në tejkalim të afatit ligjor. Në datë 10.3.2023, administrata e KQZ i ka kërkuar institucioneve nëpërmjet email-it, informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljeve, si dhe të drejtën e tyre për t'u paraqitur në seancën publike të datës 15.3.2023, ora 12:00.

Palët e interesuara depozituan pranë KQZ-së pretendimet e tyre si vijon:

1. Kryeministria ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 2 (dy) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

-“Vizitë në Universitetin e Sporteve” raportuar më datë 6.3.2023 për t'u zhvilluar më datë 10.3.2023

-“Aktivitet ku Bashkia e Tiranës do të prezantojë Strategjinë e Zhvillimit të Bashkisë Tiranë”, raportuar më datë 9.3.2023 për t'u zhvilluar më datë 13.3.2023

Kryeministria nëpërmjet email-it të datës 10.3.2023 ka sqaruar se: *Lidhur me raportimin e aktiviteteve në kohë në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ju bëj me dije se nuk janë aktivitete që organizon Kryeministria si institucion. Në të dy aktivitetet e cituara prej jush, Kryeministri i vendit është pjesëmarrës, i ftuar. Duke u nisur nga impenjimet e shumta që Kryeministri ka në agjendën e tij, janë vlerësuar si prioritare angazhime të tjera të tij. Për korrektesë ndaj afateve që përcakton Kodi Zgjedhor, edhe pse Kryeministri është vetëm pjesëmarrës dhe jo organizues i aktivitetit, është raportuar në ndërfaqe në momentin e parë që është parashikuar në agjendën e tij pjesëmarrja në aktivitet.*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet, vlerëson se Kryeministria nuk ka pasur mundësi të raportojë në kohë për këto aktivitete për shkak se është në cilësinë e të ftuarit. Sipas nenit 92, pika 1, të Kodit Zgjedhor, kanë detyrimin për të raportuar në KQZ, të gjitha institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë veprimtari me karakter publik, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

2. Ministria e Arsimit dhe Sportit ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

-Aktivitet “Vizitë në laboratorin e ri të matjeve në Universitetin e Sporteve Tiranë” raportuar më datën 6.3.2023 për t'u zhvilluar më datën 10.3.2023

Ministria e Arsimit dhe Sportit nëpërmjet email-it të datës 13.3.2023, ka paraqitur pretendimet dhe ka sqaruar se: *Ky aktivitet ishte planifikuar të zhvillohej në këtë datë për arsye të prezencës së Profesorit të mirënjohur të Universitetit të Budapestit në fushën e Sportit z. Tibor Hortobay, njëkohësisht Shef i Departamentit të Kërkimit për Shkencat Sportive. Aktiviteti u zhvillua në kuadër të vënies në punë të laboratorit të ri në këtë universitet ku prezenca e Ministres zj. Kushi ishte e domosdoshme ndërsa aktiviteti i planifikuar nga Universiteti i Sporteve në Tiranës ishte në këtë datë. Gjithashtu, ju bëjmë me dije se aktiviteti është zhvilluar pa praninë e mediave, studentëve dhe personelit akademik.*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet, vlerëson se Ministria e Arsimit dhe Sportit nuk ka patur mundësi të raportojë në kohë për këto aktivitete për shkak se është në cilësinë e të ftuarit nga Universiteti i Sporteve, nuk është organizuar prej tyre si aktivitet. Sipas nenit 92, pika 1, të Kodit Zgjedhor, kanë detyrimin për të raportuar në KQZ, të gjitha institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë veprimtari me karakter publik, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

3. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktiviteti “Takim me infermierët e rinj të punësuar nga Portali “Infermierë për Shqipërinë”, raportuar më datën 7.3.2023 për t’u zhvilluar më datën 9.3.2023

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nëpërmjet emailit të datës 15.3.2023 ka paraqitur pretendimet e veta dhe ka sqaruar se: *Në lidhje me vonesën në raportimin e aktivitetit të sjellë në vëmendje, ju bëjmë me dije se ditën e shtunë, datë 4.3.2023, ka qenë e pamundur për të aksesuar ndërfaqen e KQZ nga ana jonë. Në këto kushte, në kuadër të detyrimit për të raportuar çdo aktivitet me karakter publik, aktiviteti i sipërpërmendur nuk është raportuar në përputhje me afatet e përcaktuara.*

Në këto kushte, duke mirëkuptuar rastet e problematikave që shkakton sistemi në ndërfaqe, tërheq vëmendjen Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale që në vijim, kur është i pamundur teknikisht aksesimi i ndërfaqes, të dërgojnë raportimin nëpërmjet email-it zyrtar ose nëpërmjet shërbimit të shpejtë postar brenda afatit ligjor.

4. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktiviteti “Kongresi i Parë i Shëndetësisë që organizohet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale” raportuar më datën 3.3.2023 për t’u zhvilluar më datën 6.3.2023.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, nëpërmjet email-it të datës 13.3.2023, ka paraqitur pretendimet dhe ka sqaruar se: *Referuar email-it të mëposhtëm, lidhur me aktivitetin që është zhvilluar me datë 6.3.2023, ora 9:00, në Tiranë, pranë Pallatit të Kongreseve, i cili është publikuar më datë 3.3.2023, ju bëjmë me dije se, ky aktivitet nuk është publikuar në kohë për shkak se organizues ka qenë një institucion tjetër dhe prezenca e zj. Bello si e ftuar, nuk ka qenë e sigurtë për shkak të axhendës së ngarkuar të punës. Menjëherë pas konfirmimit të pjesëmarrjes nga ana e zj. Bello, kemi raportuar në faqen e KQZ-së si dhe e kemi përcjellë një e-mail sqarues në adresën: institucione@kqz.gov.al duke bërë me dije dhe sqaruar mbi arsyet e vonesës së publikimit për këtë aktivitet. Sa më sipër, ky informacion mund të verifikohet në email-in e përcjellë më datë 3.3.2023, në të cilin është dhënë sqarimi përkatës.*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet, vlerëson se Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka pasur mundësi të raportojë në kohë për këtë aktivitet për shkak se është në cilësinë e të ftuarit nga Ministria e Shëndetësisë. Sipas nenit 92, pika 1, të Kodit Zgjedhor, kanë detyrimin për të raportuar në KQZ, të gjitha institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë veprimtari me karakter publik, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

5. Ministria e Kulturës ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet “Takim me mësues pensionistë me rastin e festës së 7 marsit”, raportuar më datën 3.3.2023 për t’u zhvilluar më datën 7.3.2023

Ministria e Kulturës, nëpërmjet email-it të datës 13.3.2023, ka paraqitur pretendimet dhe ka sqaruar se: *Lidhur me aktivitetin "Takim me mësues pensionistë me rastin e festës së 7 marsit", ju informojmë se është një veprimtari e planifikuar për t'u organizuar nga Ministria e Kulturës, por raportimi është bërë në momentin e konfirmimit nga ana e pjesëmarrësve në aktivitet në këtë rast mësuesit. Megjithatë, në konsideratë të parashikimit lidhur me raportimin e veprimtarive publike 4 (katër) muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, ju bëjmë me dije se nga ana jonë është njoftuar me përgjegjshmëri ligjore në të njëjtën datë në të cilën Ministres së Kulturës i është konfirmuar aktiviteti.*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, vlerëson se ky aktivitet nuk ka qenë e mundur të raportohet në kohë për shkak të konfirmimit të mësuesve, pjesëmarrës në aktivitet.

6. Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambli Popullor ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktiviteti “Forumi Ndërkombëtar i Arkitekturës dhe Teknologjisë “SHARE Albania 2023” raportuar më datën 3.3.2023 për tu zhvilluar më datën 7.3.2023.

Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambli Popullor nëpërmjet emailit të datës 17.3.2023 ka paraqitur pretendime në lidhje me këtë aktivitet dhe ka sqaruar se: *Duam të vëmë në vëmendjen tuaj që TKOBAP-ja ishte vetëm institucioni mikëpritës me hapësirën e tij strukturore dhe jo organizator i këtij eventi.*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, përshkrimi i veprimtarisë së raportuar në ndërfaqe, konstatoi se kjo veprimtari është organizuar në kuadër të bashkëpunimit ndërinstytucional mes Ministrisë së Kulturës, Fakultetit të Arkitekturës dhe Share Architects, të cilët do të organizojnë në datën 7 mars Forumin e 6-të Ndërkombëtar të Arkitekturës dhe Teknologjisë, ku Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambli Popullor është përdorur si vendi i zhvillimit të aktivitetit, por jo në cilësinë e organizuesit. Sipas nenit 92, pika 1, të Kodit Zgjedhor, kanë detyrimin për të raportuar në KQZ, të gjitha institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë veprimtari me karakter publik, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

7. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktiviteti me temë “Trajnim për rolin e policisë në zgjedhje”, raportuar më datën 3.3.2023 për t’u zhvilluar më datën 6.3.2023.

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, nëpërmjet email-it të datës 10.3.2023, ka paraqitur pretendimet dhe ka sqaruar se: *Lidhur me raportimin tonë pranë Institucionit tuaj në datën 3.3.2023 të aktivitetit që do të zhvillohej në datën 6.3.2023 me temë “Trajnim për rolin e policisë në zgjedhje”, vonesa përtej afatit ka ardhur si rezultat i miratimit me vonesë të Programit dhe konfirmimit të pjesëmarrësve të ftuar në këtë aktivitet, si: Kreu i prezencës së OSBE-së në Shqipëri, SHTZ Guido De SANCTIS; Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve z. Ilirjan CELIBASHI; Prokurori i Përgjithshëm, z. Olsian ÇELA.*

Programi i këtij aktiviteti për shkaqe të arsyeshme është miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit me nr. 380/18 prot, datë 3.3.2023, datë në të cilën Personit të Kontaktit dhe çështjet e raportimit të veprimtarive me karakter publik të strukturave të Policisë së Shtetit e ka raportuar nëpërmjet ndërfaqes për raportimin e aktiviteteve publike, e cila administrohet nga KQZ. Bashkëlidhur Programi nr.380/18 prot, datë 3.3.2023, “Mbi fillimin e

procesit të trajnimeve për punonjësit e policisë “Roli dhe detyrat e Policisë së Shtetit gjatë procesit zgjedhor për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023”. Për shkak të natyrës së shërbimit dhe emergjencave që karakterizojnë veprimtarinë e Policisë së Shtetit ndodh që planifikimi i aktiviteteve të ndryshme, të bëhet në një afat më të shkurtër se pesë ditë, dhe në këto rrethana do të dëshironim mirëkuptimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që ky informacion të jetë sqarues për këto raste. Strukturat e Policisë së Shtetit janë të angazhuara maksimalisht për respektimin e Kodit Zgjedhor dhe akteve të tjera me karakter normativ të nxjerra nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, lidhur me procesin zgjedhor.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, referuar rrethanave dhe fakteve të paraqitura konstaton se veprimtaria është organizuar në kuadër të zhvillimit të zgjedhjeve lokale të datës 14.5.2023 me pjesëmarrjen e KQZ-së dhe pjesëmarrësve të tjerë. Në këto kushte, nuk mund të raportohet në kohë në ndërfaqe për shkak të konfirmimit të tyre për pjesëmarrje.

8. Prefekti i Qarkut Elbasan ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon

- Aktiviteti “E ftuar në Sofra Elbasanase, aktivitet në kuadër të festimeve të Ditës së Verës”, raportuar më datën 6.3.2023 për tu zhvilluar më datën 10.3.2023

Prefekti i Qarkut Elbasan, nëpërmjet email-it të datës 13.3.2023 ka paraqitur pretendimet e veta dhe ka sqaruar se: *Në përgjigje të kërkesës tuaj për paraqitje të pretendimeve në procesin administrativ, dërguar në email-in e personit të kontaktit me KQZ-në të Institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan: nestikapurani@yahoo.it, lidhur me raportimin e aktivitetit “Sofra Elbasanase”, ju sqarojmë si më poshtë: Aktiviteti në fjalë është një nga shumë aktivitetet e organizuara nga Bashkia Elbasan në kuadër të festimeve të Ditës së Verës, një festë kjo tashmë kombëtare por që traditën e ka në zonën e Elbasanit. Festimet për këtë festë kulmojnë në datën 14 mars, por nga bashkia organizohen dhe shumë aktivitete të tjera që fillojnë disa ditë më përpara. Në aktivitetin Sofra Elbasanase, një aktivitet ku ishin të ftuar personalitete të ndryshme, ishte ftuar dhe Prefekti i Qarkut Elbasan. Duke qenë se të hënën, më datë 6 mars, jemi njohur me agjendën e plotë të aktiviteteve të organizuara nga Bashkia Elbasan, po atë ditë duke gjykuar se ishim brenda limitit 5 ditor, e raportuam këtë aktivitet ku Prefekti ishte i ftuar të merret pjesë, për të qenë korrekt me detyrimin në fjalë. Gjithashtu, ju bëjmë me dije se aktiviteti është zhvilluar pa praninë e mediave. Sa më sipër, duke gjykuar se Sofra Elbasanase nuk ishte një aktivitet i organizuar nga institucioni ynë, por një aktivitet ku Prefekti i Qarkut ishte i ftuar, besojmë në mirëkuptimin tuaj në shqyrtimin e këtij rasti.*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, vlerëson se Prefekti i Qarkut Elbasan nuk ka pasur mundësi të raportojë në kohë për këto aktivitete për shkak se është në cilësinë e të ftuarit. Sipas nenit 92, pika 1, të Kodit Zgjedhor, kanë detyrimin për të raportuar në KQZ, të gjitha institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe

agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë veprimtari me karakter publik, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

9. Njësia Administrative nr.9 ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:
- Aktiviteti “Në shkollën 9-vjecare "7 marsi" është menduar që të zhvillohet një aktivitet me rastin e ditës së mësuesit që shënohet si një ngjarje kulturore dhe me rëndësi në të gjithë vendin tonë”, raportuar më datën 6.3.2023 për t’u zhvilluar më datën 7.3.2023

Njësia Administrative nr. 9, këtë aktivitet e ka raportuar me shkresën e tyre nr.709 prot., datë 2.3.2023, administruar në KQZ me shkresën nr. 1371 prot., datë 6.3.2023, dhe veprimtaria ka qenë planifikuar për tu zhvilluar në datë 7.3.2023. *Në shkresë kanë sqaruar se sistemi online për raportim nuk ka qënë i aksesueshëm nga ana e tyre dhe kanë bërë disa përpjekjeve të vazhdueshme, për këtë arsye raportimin e kanë bërë në mënyrë shkresore. Ky aktivitet është bërë me prezencën e mësuesve, nxënësit, administratorit të Njesisë Administrative dhe Ministres së Shëndetësisë zj. Ogerta Manastirliu, pa praninë e mediave.*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet vlerëson se raportimi nga Njësia Administrative nr. 9 është bërë direkt sapo kanë konstatuar pamundësinë e aksesimit të ndërfaqes së raportimeve, dhe nëse do të merret parasysh data e dërgimit të shkresës së tyre, konsiderohet se afati pesë ditor është respektuar. Në këto kushte, duke mirëkuptuar problematikat e sistemit online të raportimit, konsiderohet se nuk jemi para një kundërvajtje administrative.

10. Qendra Komunitare Multidisipilinare, ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2, të Kodit Zgjedhor, si vijon:
- Aktivitet “Ky aktivitet organizohet me iniciativën e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Sociale dhe Aleancës së Grave Këshilltare për të mbështetur dhe qenë pranë grave dhe vajzave në nevojë”, raportuar më datën 4.3.2023 për t’u zhvilluar më datën 8.3.2023.

Qendra Komunitare Multidisipilinare, nëpërmjet email-it të datës 15.3.2023, ka paraqitur pretendimet dhe ka sqaruar se: *Në momentin që janë dërguar të dhënat me kredencialet e personit përgjegjës për të regjistruar aktivitetet, sistemi ka patur problem dhe Qendra Komunitare Multidisipilinare nuk është loguar dot. Nga kjo pamundësi kemi bërë email përgjigje, në emailin që na ka nisur të dhënat (aktivitete@kqz.gov.al) dhe skemi marrë asnjë përgjigje. Email-et do ti bashkëlidhim kësaj shkrese. Gjithashtu, në datën 3 mars, Juristja e institucionit ka marrë njoftimin për realizimin e aktivitetit në qendër dhe ka nisur procedurën*

për regjistrimin e aktivitetit. Duke qenë se sërish nuk punonte sistemi dhe nuk mundeshim të bënim regjistrimin e aktivitetit, kemi arritur të komunikojmë me telefon dhe me bisedë ne whatsapp me punonjës IT të KQZ, të cilët kanë vijuar me zgjidhjen e problemit. Në datën 4 mars na janë nisur kredencialet për institucionin tonë dhe në këtë moment kemi bërë direkt regjistrimin e aktivitetit. Sipas shpjegimit të mësipërm, ju vëmë në dijeni që aktiviteti është bërë në qendër me persona përfitues të qendrës dhe arsye e mospublikimit në kohën e duhur, pra, për 1 dite afat kohor ka qenë për shkak të problemeve të sistemit, të cilat nuk kanë funksionuar në momentin e duhur. Sa më sipër, kërkojmë nga ana juaj që procedura të mos vijojë për shkak se ka pasur pamundësi objektive.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, referuar rrethanave dhe fakteve të paraqitura konstaton se janë bërë të gjitha përpjekjet nga ana e tyre për raportimin e aktiviteteve online por për shkak të problemeve teknike nuk është mundësuar të raportohen në kohë, për këtë arsye mirëkuptohet situata dhe nuk konsiderohet si kundërvajtje administrative.

11. Bashkia Belsh ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 2 (dy) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

1. Aktivitet “Bashkëbisedim me komunitetin për problemet dhe projektet që ka fshati” raportuar më datën 5.3.2023 për t’u zhvilluar më datën 9.3.2023,
2. Aktiviteti “Bashkëbisedim me fermerët” raportuar më datën 5.3.2023 për t’u zhvilluar më datën 9.3.2023

Bashkia Belsh nëpërmjet emailit të datës 10.3.2023 ka paraqitur pretendimet dhe ka sqaruar se: *Lidhur me takimet e raportuara nga Bashkia Belsh më datë 5.3.2023 për t’u zhvilluar në datën 9.3.2023 përtej limiteve të afatit 5 ditor, Ju sqarojmë se për datat 3.3.2023 të premtën në Bashki kishim probleme interneti, edhe datë 4.3.2023 nuk kisha internet në shtëpi, kështu që raportuam në datë 5.3.2023 të gjitha aktivitetet. Në vazhdim do të jemi korrekt me afatet ligjore të raportimit.*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, referuar rrethanave dhe fakteve të paraqitura vlerëson se Bashkia Belsh ka patur probleme me internetin dhe për këtë arsye kanë raportuar aktivitetet për t’u zhvilluar, me vonesë.

Në këto kushte, duke mirëkuptuar rastet e problematikave që shkaktohen për shkaqe të pavarura nga institucioni, tërheq vëmendjen Bashkisë Belsh që në vijim, kur është i pamundur teknikisht aksesimi i ndërfaqes, të dërgojnë raportimin nëpërmjet email–it zyrtar ose nëpërmjet shërbimit të shpejtë postar.

12. Bashkia Elbasan ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 3 (tre) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- “Aktivitet artistik me rastin e Ditës së Verës”, raportuar më datën 9.3.2023 për t’u zhvilluar më datën 12.3.2023,
- Aktiviteti “Sofra Elbasanase, aktivitet kulturor në kuadrin e ditës së verës”, raportuar më datën 7.3.2023 për t’u zhvilluar më datën 10.3.2023,

Bashkia Elbasan nuk ka paraqitur pretendime në lidhje me këtë aktivitet, nuk ka qënë prezent as në seancën publike të zhvilluar.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, referuar rrethanave dhe fakteve të raportuara në ndërfaqe dhe tematikës së aktiviteteve, vlerëson se veprimtaritë e raportuara jashtë afatit nuk përbëjnë veprimtari publike me detyrim për raportim.

13. Bashkia Gjirokastrë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 3 (tre) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

1. Aktiviteti “Mbi arsimin dhe koncert me rastin e 7 marsit, organizuar nga nxënës të shkollave të Bashkisë Gjirokastrë”, raportuar më datën 3.3.2023, për t’u zhvilluar më datë 6.3.2023
2. Aktiviteti “Vizitë në banesat e ish mësuesve, tashmë të dalë në pension, të cilët janë në pamundësi lëvizjeje”, raportuar më datën 3.3.2023, për t’u zhvilluar më datë 7.3.2023
3. Aktiviteti “Mirënjohje dhe vlerësim me certifikatë i 12 mësuesve”, raportuar më datë 3.3.2023 për t’u zhvilluar më datë 7.3.2023.

Bashkia Gjirokastrë, nëpërmjet emailit të datës 13.3.2023 ka paraqitur pretendime në lidhje me zhvillimit e këtij aktiviteti dhe ka sqaruar se: *Aktivitet e sipërcituara ishin aktivitete me karakter kulturor të cilat nuk hyjnë në kategorinë e veprimtarive të ndaluara sikurse janë veprimtaritë politike zgjedhore: promovimi i investimeve me pjesëmarrjen e elektoratit e përfaqësuesve të partive politike, pjesëmarrja e punonjësve të administratës brenda orarit zyrtar të punës në këto lloj veprimtarie, promovimi i projekteve të ndryshme në investime, shërbime për të cilat fondet janë planifikuar pas datës 13 janar etj. Pra përse më sipër bëhet fjalë për aktivitete të cilat ishin planifikuar dhe ishin bërë përgatitjet për zhvillimin e tyre në datat 6 dhe 7 mars dhe mosraportimi brenda afatit 5 ditor erdhi si rezultat i mosraportimit në kohë te personi përgjegjës, i cili ka akses në ndërfaqe për raportimin e informacionit të deleguar nga sektorët përkatës në ndërfaqen për raportim. Agjendën për këto aktivitete nuk e disponon Sekretari i Përgjithshëm, apo sipas rastit, personat e tjerë të autorizuar për raportimin e aktiviteteve, por vetëm personat të cilët merren me planifikimin dhe organizimin e veprimtarive publike. Sektorët përkatës të planifikimit të aktiviteteve janë njoftuar*

lidhur me detyrimet që rrjedhin sipas nenit 92 të Kodit Zgjedhor dhe sipas rastit dërgojnë informacionin që disponojnë për t'u raportuar, lidhur me aktivitet që do të organizohen. Duke qënë në situatën që këto aktivitet u raportuan me vonesë (në datë 3 mars) te personi i autorizuar për raportim, u gjykua që të raportoheshin edhe pse nga data e marrjes se informacionit për raportim nuk plotësohej minimumi kohor prej 5 (pesë ditësh), kjo për arsye se këto aktivitete nuk mund të anuloheshin edhe as të shtyeshin për një datë të mëvonshme pasi ishin të lidhura me një ditë specifike sikurse është festa e 7 marsit. Pra, për sa më sipër, u gjykua që raportimi me vonesë do të ishte rrethanë më lehtësuese sesa mosraportimi në tërësi i aktiviteteve të planifikuara dhe për këto arsye, vazhduam me procesin e raportimit, edhe pse nuk plotësohej minimumi kohor i raportimit. Personat të cilët raportuan me vonesë u rivendosën në dënim lidhur me penalitetet e mosraportimit në kohë në mënyrë që kjo problematikë të mospërsëritet më në të ardhmen.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, referuar rrethanave dhe fakteve të raportuara në ndërfaqe dhe hetimit të kryer, vlerëson se këto veprimtari për shkak të tematikës së tyre, nuk përbëjnë veprimtari me karakter publik dhe në këto kushte nuk jemi para kundërvajtjes administrative.

14. Bashkia Gramsh ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon

- Aktiviteti “Ceremoni për nder të mësuesve të dalë në pension në periudhën mars 2022-mars 2023”, raportuar më datë 6.3.2023 për tu zhvilluar më datë 10.3.2023

Bashkia Gramsh nëpërmjet email-it të datës 13.3.2023, ka paraqitur pretendimet dhe ka sqaruar se: *Lidhur me konstatimin tuaj se, nga verifikimi i kryer për një veprimtari të organizuar me objekt “Ceremoni për nder të mësuesve të dalë në pension për periudhën mars 2022-mars 2023”, sqarojmë se: Kjo veprimtari është raportuar nga bashkia Gramsh në ndërfaqen e raportimit të veprimtarive publike më datë 6.3.2023 ora 8:38. Kjo veprimtari është një veprimtari e përvitshme e organizuar nga Zyra Vendore e Arsimit Gramsh (ZVA). Bashkia Gramsh nuk ka qenë organizatore e këtij aktiviteti, por ka qenë si e ftuar nga Zyra Vendore e Arsimit Gramsh, ftesë drejtuar kryetarit të bashkisë. Pavarësisht se nuk është bashkia Gramsh organizatore e aktivitetit, duke qenë se i ftuar ka qenë kryetari i bashkisë, ne e kemi raportuar që në momentin e marrjes së ftesës, pikërisht mëngjesin e datës 6.3.2023, për të qenë transparent me publikun, edhe pse detyrimi për raportimin e aktivitetit nuk rëndon mbi institucionin tonë. Theksojmë se kryetari i bashkisë ka qenë në cilësinë e të ftuarit në këtë ceremoni.*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura vlerëson se, Bashkia Gramsh nuk ka pasur mundësi të raportojë në kohë për këto aktivitete për shkak se është në cilësinë e të ftuarit nga Zyra Vendore Arsimore Gramsh. Sipas nenit 92, pika 1, të Kodit Zgjedhor, kanë detyrimin për të raportuar në KQZ, të gjitha institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të

zhvillojnë veprimtari me karakter publik, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

15. Bashkia Kolonjë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon

- Aktiviteti “Mirënjohje për kontributin e mësuesve”, raportuar më datë 3.3.2023 për t’u zhvilluar më datë 7.3.2023

Bashkia Kolonjë nëpërmjet email-it të datës 13.3.2023, ka paraqitur pretendimet dhe ka sqaruar se: *Bashkia Kolonjë lidhur me aktivitetin "Mirënjohje për kontributin e mësuesve" raportuar në datë 3.3.2023 për tu zhvilluar në datë 7.3.2023 është bërë gabim llogaritje, përsa i përket afatit 5 ditor. Janë marrë të mirëqena data 3/4/5/6/7, pra 5 ditë. Duke ju kërkuar ndjesë, ju bëjmë me dije se nga ky moment do të respektohet afati për cdo veprimtari tjetër që do të raportohet.*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, vlerëson se është bërë një gabim në llogaritjen e afatit 5 ditor të raportimit, duke moskuptuar drejt mënyrën e llogaritjes së afatit. Arsyeja e raportimit në shkelje të afatit nuk ka qenë shmangia nga detyrimi për raportim.

16. Bashkia Korçë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 3 (tre) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

1. Aktiviteti “Homazhe në nderim të viktimave që humbën jetën në aksidentin hekurudhor në Greqi”, raportuar më datë 4.3.2023 për t’u zhvilluar më datë 5.3.2023.
2. Aktiviteti “Ekspozitë e sendeve personale, fotografive dhe materiale në video të personaliteteve që lidhen me shkollat e para, kryesisht mësuesit, nxënësit dhe kontribuesit”, raportuar më datë 3.3.2023 për t’u zhvilluar më datë 7.3.2023.
3. Aktiviteti “Me rastin e 7 marsit-Festës së Mësuesit, Shoqata e pensionistëve shqiptarë nga Struga do të bëjë një vizitë në Bashkinë Korçë, për të shprehur urimet e tyre për këtë festë”, raportuar më datë 3.3.2023 për tu zhvilluar më datë 7.3.2023.

Bashkia Korçë nëpërmjet email-it të datës 15.3.2023 ka paraqitur pretendimet dhe ka sqaruar se: *Në përgjigje të email tuaj mbi raportimin e 3(tre) veprimtarive publike përtej afatit ligjor sqarojmë se: 1.Raportimin mbi homazhet në nderim të viktimave që humbën jetën në aksidentin hekurudhor në Greqi ishim të detyruar ta bënim një ditë para, pasi njoftimin nga Konsullata Greke për mbajtjen e homazheve e kemi marrë më datë 4.3.2023. Për këtë arsye ju kemi vënë edhe ju në dijeni me anë të email-it, të cilin po ja u dërgojmë sërish për verifikim.*

2. Raportimin për pjesëmarrjen e kryetarit në ekspozitën në Muzeun Kombëtar të Arsimit, e kemi bërë ditën kur konfirmuam orën e zhvillimit të këtij aktiviteti, pasi krijohet përplasje me aktivitete të tjera të planifikuara. 3. Kërkesa e Shoqatës së pensionistëve shqiptarë nga Struga për të vizituar bashkinë dhe për të zhvilluar një takim me kryetarin e Bashkisë Korçë me rastin e 7 marsit erdhi më datë 2.3.2023. Në datë 3.3.2023 u bë i mundur konfirmimi i këtij takimi dhe më pas raportimi i tij. Për sa më sipër, kërkojmë nga ana juaj të merren në konsideratë arsyet për raportimin e veprimtarive përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet, vlerëson se:

Për aktivitetin e parë të zhvilluar ka qenë e pamundur respektimi i afatit 5 ditor të raportimit pasi ndodhemi në kushtet e një veprimtarie të zhvilluar në nderim të personave që kanë humbur jetën në një aksident tragjik, të pavarura nga shkaqe, për të cilat mund të respektohej ky detyrim.

Përsa i përket aktivitetit të dytë, konsiderohet që është një veprimtari që nuk është organizuar nga ky institucion, por ka patur pjesëmarrjen e Kryetarit të Bashkisë në cilësinë e të ftuarit, në këto kushte nuk ka patur as detyrim për raportim në ndërfaqen e KQZ-së.

Në lidhje me aktivitetin e tretë, për shkak të tematikës së aktivitetit, nuk krijohet bindja që është një veprimtari me karakter publik, që ka detyrim për raportim.

17. Bashkia Lezhë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 4 (katër) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon

1. “Aktiviteti në kuadër të 8 marsit me gratë pensioniste dhe profesione të lira”, raportuar më datë 3.3.2023 për t’u zhvilluar më datë 7.3.2023.
2. Aktiviteti “Inspektim i punimeve të përfunduara në rrugën e Shënkolli”, raportuar më datë 6.3.2023 për t’u zhvilluar më datë 7.3.2023.
3. Aktiviteti “Takim me banorët e fshatit Ishull Lezhë, për të diskutuar rreth investimeve të bëra”, raportuar më datë 6.3.2023 për t’u zhvilluar më datë 10.3.2023.
4. Aktiviteti “Takim konsultues me pjesëmarrjen e drejtorit rajonal të OSHEE-së në disa fshatra si Raboshtë, Gjadër, Zejmen”, raportuar më datë 9.3.2023 për t’u zhvilluar më datë 13.3.2023.

Bashkia Lezhë nuk ka paraqitur pretendimet në lidhje me veprimtaritë e raportuara me vonesë, as nuk ka qenë prezent në seancën publike të zhvilluar.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, vlerëson se në lidhje me aktivitetin “Në kuadër të 8 marsit me gratë pensioniste dhe profesione të lira”,

për shkak të tematikës së veprimtarisë së raportuar, nuk krijohet bindja që është një veprimtari me karakter publik, që ka detyrim për raportim.

Në lidhje me aktivitetet “Inspektim i punimeve të përfunduara në rrugën e Shënkollit” “Takim me banorët e fshatit Ishull Lezhë për të diskutuar rreth investimeve të bëra” dhe “Takim konsultues me pjesëmarrjen e drejtorit rajonal të OSHEE-së në disa fshatra si Raboshtë, Gjadër, Zejmen”, nuk rezulton nga verifikimi i kryer që këto veprimtari të jenë publikuar në asnjë media. Në këto kushte nuk krijohet bindja për karakterin publik që ato kanë.

18. Bashkia Maliq ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 11 (njëmbëdhjetë) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

1. Aktiviteti “Inspektimi i punimeve për asfaltimin e një prej rrugëve të brendshme të fshatit Vreshtas”, raportuar më datë 3.3.2023 për t’u zhvilluar më datë 3.3.2023.
2. Aktiviteti “Takim pune në Sheqeras”, raportuar më datë 7.3.2023 për t’u zhvilluar më datë 7.3.2023.
3. “Aktivitet për 7 marsin”, raportuar në datë 7.3.2023 për t’u zhvilluar në datë 7.3.2023.
4. Aktiviteti “Takim pune në Pirg”, raportuar më datë 7.3.2023 për t’u zhvilluar më datë 7.3.2023.
5. “Aktivitet për 8 marsin ne Pirg”, raportuar më datë 7.3.2023 për t’u zhvilluar më datë 8.3.2023.
6. “Aktivitet për 8 marsin në Libonik”, raportuar më datë 7.3.2023 për t’u zhvilluar më datë 8.3.2023.
7. “Aktivitete me gratë ne Maliq”, raportuar më datë 7.3.2023 për t’u zhvilluar më datë 9.3.2023.
8. Aktiviteti “Inspektim punimesh ne Shëngjergj”, raportuar më datë 7.3.2023 për t’u zhvilluar më datë 9.3.2023.
9. Aktiviteti “Konsultim publik me të rinjtë e fshatit Kakac”, raportuar më datë 7.3.2023 për t’u zhvilluar më datë 9.3.2023.
10. Aktiviteti “Takim pune Gore”, raportuar më datë 7.3.2023 për t’u zhvilluar më datë 10.3.2023.
11. Aktiviteti “Takim pune në Moglicë”, raportuar më datë 7.3.2023 për t’u zhvilluar më datë 10.3.2023.

Bashkia Maliq nëpërmjet email-it të datës 15.3.2023, ka paraqitur pretendimet dhe ka sqaruar se: *Në përgjigje të email-it të dërguar nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në datën 10.3.2023 në lidhje me 11 (njëmbëdhjetë) veprimtaritë e raportuara nga Bashkia Maliq për periudhën 3.3.2023-9.3.2023, ju parashtrojmë pretendimet tona si më poshtë:*

*Përsa i përket veprimtarisë nr.1 :“Inspektimi i punimeve për asfaltimin e një prej rrugëve të brendshme të fshatit Vreshtas”, raportuar më datë 3.3.2023 për t’u zhvilluar në datë 3.3.2023, sqarojmë se **Bashkia Maliq është pajisur me kredenciale nga ana e KQZ në datën 28.2.2023** (fotoja bashkangjitur) dhe për datat 1/2/3/4/5 Mars 2023 institucioni ynë nuk ka patur mundësi që të raportojë brenda afatit ligjor 5 ditor përpara veprimtarisë së zhvilluar që parashikon neni 92, pika 2, e ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.*

*Përsa i përket veprimtarisë nr.2 “Takim pune në Sheqeras”, raportuar në datë 7.3.2023 për t’u zhvilluar më datë 7.3.2023, Veprimtarisë nr.4 “Takim pune në Pirg”, raportuar më datë 7.3.2023 për t’u zhvilluar në datë 7.3.2023. **Këto takime pune nuk janë zhvilluar** pasi data 7 mars përkon me festën zyrtare të mësuesit dhe titullari i institucionit z. Gëzim Topciu është ftuar në disa aktivitete kulturore në këtë datë.*

*Përsa i përket veprimtarisë nr.3 “Aktivitet për 7 marsin”, raportuar më datë 7.3.2023 për tu zhvilluar në datë 7.3.2023; veprimtarisë nr.5 "Aktivitet për 8 marsin në Pirg", raportuar më datë 7.3.2023 për t’u zhvilluar në datë 8.3.2023; Veprimtarisë nr.6 “Aktivitet për 8 marsin në Libonik”, raportuar në datë 7.3.2023 për t’u zhvilluar në datë 8.3.2023; Veprimtarisë nr.7 “Aktivitete me gratë në Maliq”, raportuar më datë 7.3.2023 për t’u zhvilluar më datë 9.3.2023, sqarojmë se këto janë aktivitete kulturore festive që **nuk organizohen nga Bashkia Maliq** dhe titullari ka qenë i ftuar të marrë pjesë nga keto aktivitete, 1 ose 2 dite para dhe për këtë arsye ka qenë e pamundur që të raportoheshin brenda afatit ligjor, sikurse e parashikon ligji.*

Përsa i përket veprimtarisë nr. 8 “Inspektim punimesh në Shëngjergj”, raportuar më datë 7.3.2023 për t’u zhvilluar më datë 9.3.2023, sqarojmë se Kryetari i Bashkisë është njoftuar për inspektimin e punimeve në Shëngjergj nga operatori privat që kryen punimet në sistemin e kanalizimeve në Shëngjergj për këtë arsye nuk ka qenë e mundur respektimi i afatit 5 ditor që parashikon ligji.

Përsa i përket veprimtarisë nr.9, 10, 11 “Konsultim publik me të rinjtë e fshatit Kakac”, raportuar më datë 7.3.2023 për t’u zhvilluar më datë 9.3.2023, “Takim pune në Gore”, raportuar më datë 7.3.2023 për t’u zhvilluar më datë 10.3.2023. “Takim pune në Moglicë”, raportuar më datë 7.3.2023 për t’u zhvilluar në datë 10.3.2023, sqarojmë se këto takime nuk janë zhvilluar nga ana e Kryetarit të Bashkisë dhe janë shtyrë të zhvillohen në data të tjera.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, vlerëson se: Për veprimtarinë e parë nuk ka patur mundësi ta raportojë në kohë për shkak se janë pajisur me kredenciale vetëm në datë 28.2.2023.

Për veprimtarinë e dytë dhe të katërt, konstatohet se nuk janë zhvilluar dhe në këto kushte nuk jemi para kundërvajtjes administrative për aq kohë sa nuk është zhvilluar.

Për veprimtarinë e tretë, pestë, gjashtë dhe shtatë, Bashkia Maliq ka qenë në cilësinë e të ftuarit dhe nuk ka patur detyrim për raportim, pasi nuk janë organizuar prej tyre.

Për veprimtarinë e nëntë, dhjetë dhe njëmbëdhjetë konstatohet se nuk janë zhvilluar, janë shtyrë për më vonë, dhe në këto kushte nuk jemi para kundërvajtjes administrative për aq kohë sa nuk është zhvilluar.

Për veprimtarinë e tetë konstatohet se është planifikuar në afate të shkurtra për shkak se duhej bërë inspektim i momentit të fundit, kërkuar nga operatori privat që i kryen këto punime. Në këto kushte ka qenë e pamundur për ti raportuar në kohë.

19. Bashkia Pogradec ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktiviteti “Me rastin e festes së 7-marsit, urojmë drejtuesit e institucioneve duke iu dhuruar lule”, raportuar më datë 3.3.2023 për t’u zhvilluar më datë 7.3.2023

Bashkia Pogradec nëpërmjet email-it të datës 10.3.2023, ka paraqitur pretendimet dhe ka sqaruar se: *“Konstatimi juaj është i drejtë në lidhje me afatin e raportimit, jo më larg se dy ditë më parë ju na nisët edhe disa aktivitete të tjera që nuk i kishim raportuar në kohë që lidheshin edhe me faktin se nuk i organizonte bashkia, apo edhe për faktin se institucione të caktuara nuk njiheshin ende me shkresën tuaj. Ndërkohë në lidhje me këtë aktivitet dua t’iu bëj me dije se nuk ka pasur takim në sallë me mësues, por një punonjës i zyrës arsimore ka dërguar në vendin e punës të çdo drejtorie një lule si formë urimi për ta. Nuk ka pasur prani as të mediave dhe as të drejtuesve të bashkisë gjatë kësaj shpërndarje dhe nisma pasi nuk është aktivitet i mirëfilltë nuk kishte qëllim shpërndarje mesazhesh politike etj, përveçse një lule në shenjë respekti. Në të ardhmen do të përpiqemi që të mos përsëriten më gabime të tilla”.*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, vlerëson se aktiviteti i raportuar nuk ka patur prezencë të medias ose publikut dhe nuk përbën veprimtari me karakter publik, që ka detyrim për raportim.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “n” dhe 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, dispozitat e ligjit nr. 10279, datë 20.05.2012 “Për kundërvajtjet administrative”, ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

VENDOS:

1. Moskonstatimin e shkeljes administrative
2. Pushimin e procedimit administrativ ndaj institucioneve si vijon:
 - a) Kryeministria,
 - b) Ministria e Arsimit dhe Sportit,
 - c) Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale,
 - ç) Ministria e Turizmit dhe Mjedisit,
 - d) Ministria e Kulturës,
 - dh) Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansambli Popullor,
 - e) Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit,
 - ë) Prefekti i Qarkut Elbasan,
 - f) Njësia Administrative nr. 9,
 - g) Qendra Komunitare Multidisiplinare,
 - gj) Bashkia Belsh,
 - h) Bashkia Elbasan,
 - i) Bashkia Gjirokastrë,
 - j) Bashkia Gramsh,
 - k) Bashkia Kolonjë,
 - l) Bashkia Korçë,
 - ll) Bashkia Lezhë,
 - m) Bashkia Maliq,
 - n) Bashkia Pogradec.
- 2) Ky vendim t'u njoftohet palëve nëpërmjet postës elektronike.
- 3) Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- 4) Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI